



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHKOLLA E MAGJISTRATURËS
KËSHILLI DREJTUES

Nr. 924/6 prot.

Tiranë, më 14.7.2025

V E N D I M

Nr. 19, datë 14.7.2025

PËR

VLERËSIMIN PËRFUNDIMTAR TË KANDIDATËVE PËR MAGJISTRATË TË VITIT
TË TRETË AKADEMIK 2024-2025 NË PROGRAMIN E FORMIMIT FILLESTAR

Në zbatim të nenit 34 të ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", nenit 268, 269 dhe 270 të ligjit nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", si dhe në nenin 42 dhe Aneksin 10 të Rregullores së Brendshme të Shkollës së Magjistraturës, Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës, i mbledhur më datë 14 korrik 2025,

V E N D O S I:

1. Të miratojë vlerësimin përfundimtar të kandidatëve për magjistratë, profili gjyqtar dhe prokuror, pas përfundimit të vitit të tretë të Programit të Formimit Fillestar në Shkollën e Magjistraturës për vitin akademik 2024-2025.
2. Një kopje e këtij vendimi t'i përcillet Këshillit të Lartë Gjyqësor për kandidatët për gjyqtar dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë për kandidatët për prokuror.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.